

20100500920

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008 dhe 48/2009), në nenin 3 paragrafi (1) pika 5 ndryshohet si vijon:

"5) "Person i lidhur" në raport me personin e caktuar juridik ose personin fizik, është:

a) aksionari individual ose grup aksionarësh të cilët posedojnë së paku 10% të aksioneve me të drejtë vote, ose posedojnë përqindje më të vogël dhe kanë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen në atë person juridik;

b) cilido person tjetër juridik te i cili personi i parë juridik në mënyrë të drejtprejtë ose të tërthortë posedon së paku 10% të aksioneve me të drejtë vote, ose posedon përqindje më të vogël dhe ka kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen për atë person juridik;

v) cilido person tjetër juridik te i cili një aksionar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë posedon më shumë se 20% të aksioneve me të drejtë vote dhe në periudhë të njëjtë kohore, aksionari i njëjtë posedon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më shumë se 20% të aksioneve me të drejtë vote te personi i parë juridik;

g) personi fizik ose personi juridik të cilët kanë kontroll të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose kontrollohen nga personi juridik ose janë nën kontroll të përbashkët të personit juridik;

d) anëtari i Këshillit Drejtues, Këshillit Mbikëqyrës ose anëtari i organit tjetër të administrimit ose mbikëqyrjes te personi juridik dhe

gj) në lidhje me personat e cekur në këtë pikë, personat të cilët janë: në farefisni nëpërmjet martesës ose birësimit; fëmijë dhe prindër, motra dhe vëllezër, motra nga nëna ose babai dhe vëllezër nga nëna ose babai, gjyshër dhe nipër; në mënyrë tjetër janë në lidhje gjaku deri në shkallë të dytë; persona të cilët janë në marrëdhënie: prind kujdestar dhe fëmijë, njerë ose njerë, i birësuar dhe e birësuar, re, dhëndër dhe prindër të bashkëshortëve.

Pas pikës 11 shtohen tre pika të reja 12, 13 dhe 14 si vijojnë:

12) "Reputacion i mirë" është ndershmëria, kompetenca, zelli për punë dhe posedimi i vetive të cilat sigurojnë se personi me mënyrën e punës së tij nuk do të ndikojë në rrezikimin e stabilitetit dhe sigurisë së shoqërisë pensionale dhe fondit me të cilin menaxhon, si dhe cënimin e autoritetit dhe besimit;

13) "Anëtar i pavarur i Këshillit Mbikëqyrës" është personi fizik i cili:

a) në pesë vitet e fundit nuk ka pasur interes material ose marrëdhënie afariste me shoqërinë si partner afarist, si i punësuar ose anëtar i Këshillit Drejtues ose Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë;

b) nuk është person i lidhur i shoqërisë, i punësuar te personi i ndërlidhur i shoqërisë ose përfaqëson person të ndërlidhur të shoqërisë;

v) nuk është person i lidhur fizik me anëtarë të Këshillit Drejtues ose Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë dhe

g) nuk ka punuar dhe nuk punon në shoqëri për revizion, e cila gjatë tre viteve të fundit ka bërë revizion të jashtëm në punën e shoqërisë dhe

14) "Material për marketing" është materiali i plotë për reklamim, promovim ose informim para lëshimit, distribuimit ose publikimit të tij, në mjetet për informim publik, i cili ka të bëjë me fondin e detyrueshëm pensional ose me shoqërinë e cila menaxhon me atë fond."

Neni 2

Në nenin 4 pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafë të rinj (2) dhe (3), si vijojnë:

"(2) Shoqëria punon në pajtim me rregullat për menaxhim të mirë korporativ.

(3) Agjencia i përcakton rregullat për menaxhim të mirë korporativ të shoqërive."

Neni 3

Në nenin 9 paragrafi (1) fjalët: "Kapitali themelues" zëvendësohen me fjalët: "Kryegjëja themelore".

Në paragrafin (4) fjala "kapitali" zëvendësohet me fjalët: "kryegjëja themelore".

Neni 4

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"(1) Kryegjëja themelore e shoqërisë është së paku 1 500 000 euro në kundërvlerë me denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në ditën e pagesës.

(2) Kur mjetet e fondit të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon shoqëria do ta tejkalojnë 100 000 000 euro dhe në çdo rast të ardhshëm kur mjetet e fondit të detyrueshëm pensional do të rriten për 100 000 000 euro shtesë, shoqëria obligohet që në afat prej 45 ditësh pune, ta zmadhojë kryegjënë e shoqërisë së paku deri në shumën si vijon:

Mjete të fondit të detyrueshëm pensional	Kryegjëja e shoqërisë
Nga 100.000.001 euro deri në 200.000.000 euro	2.500.000 euro
Nga 200.000.001 euro deri në 300.000.000 euro	3.500.000 euro
Nga 300.000.001 euro deri në 400.000.000 euro	4.500.000 euro
Nga 400.000.001 euro deri në 500.000.000 euro	5.500.000 euro
Nga 500.000.001 euro deri në 600.000.000 euro	6.500.000 euro
Nga 600.000.001 euro deri në 700.000.000 euro	7.500.000 euro
Nga 700.000.001 euro deri në 800.000.000 euro	8.500.000 euro
Nga 800.000.001 euro deri në 900.000.000 euro	9.500.000 euro
Mbi 900.000.001 euro	10.000.000 euro

(3) Eurot llogariten në kundërvlerë me denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e pagesës.

(4) Shoqëria obligohet që në çdo kohë ta mbajë vlerën e kryegjësë, por jo më pak se gjysma e vlerës së kryegjësë themelore nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Nëse vjen te zmadhimi i kryegjësë së shoqërisë në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, shoqëria obligohet që në çdo kohë ta mbajë shumën e zmadhuar të kryegjësë.

(6) Shoqëria obligohet që në çdo kohë të mbajë mjete personale, në shumë jo më të vogël se gjysma e shumës së kryegjësë themelore të shoqërisë nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Nëse vjen te zmadhimi i kryegjësë së shoqërisë në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, shoqëria obligohet që në çdo kohë të mbajë mjete personale në shumë jo më të vogël se gjysma e shumës së kryegjësë nga paragrafi (2) i këtij neni.

(8) Mjetet personale të shoqërisë nga paragrafët (6) dhe (7) të këtij neni, përbëhen nga kryegjëja themelore, rezervat dhe zërat tjerë, të llogaritura sipas metodologjisë të cilën e përcakton Agjencia.

(9) Shoqëria obligohet që në çdo kohë të mbajë shumë të mjeteve likuide, si përqindje nga kryegjëja themelore e shoqërisë nga paragrafi (1) i këtij neni, përkatësisht kryegjëja nga paragrafi (2) i këtij neni.

(10) Përqindjen minimale të mjeteve likuide nga paragrafi (9) i këtij neni, e përcakton Agjencia.

Neni 5

Në nenin 11 dhe 12 fjalët: "kapitali themelues" zëvendësohen me fjalët: "kryegjësja themelore".

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si vijon:

"(1) Shoqëria obligohet që menjëherë ta njoftojë Agjencinë për çdo zvogëlim të kryegjësë themelore, kryegjësë, mjeteve të veta ose mjeteve likuide, nën shumat e përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

(2) Agjencia mund ta heqë lejen për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional të shoqërisë nëse me zvogëlimin e kryegjësë themelore, kryegjësë, mjeteve të veta ose mjeteve likuide nën shumën e kërkuar, shoqëria nuk do të bëjë zmadhimin e tyre deri në shumën e kërkuar, në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 12 muaj."

Neni 7

Në nenin 14 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Themeluesit të cilët mund të posedojnë 51% të kryegjësë themelore të shoqërisë janë bankat, shoqëritë e sigurimit, shoqëritë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale dhe institucionet tjera financiare, si dhe persona të tjerë juridikë të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, posedojnë më shumë se 50% të aksioneve me të drejtë të menaxhimit me ato institucione. Nëse nuk ka themelues të cilët do të posedojnë 51% nga kryegjësja themelore e shoqërisë, atëherë të gjithë themeluesit e plotësojnë këtë kusht."

Neni 8

Në nenin 16 paragrafi (4) fjalët: "kapitali aksionar" zëvendësohen me fjalët: " kryegjësja themelore".

Paragrafi (7) shlyhet.

Neni 9

Neni 17 ndryshohet si vijon:

"(1) Këshilli Drejtues i shoqërisë përbëhet së paku prej dy anëtarëve.

(2) Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë përbëhet së paku prej katër anëtarëve.

(3) Nëse zvogëlohet numri i anëtarëve të Këshillit Drejtues nën numërin e paraparë në paragrafin (1) të këtij neni, Këshilli Mbikëqyrës nga radhët e veta emëron ushtrues të detyrës anëtar i Këshillit Mbikëqyrës. Anëtari i Këshillit Mbikëqyrës i cili emërohet ushtrues i detyrës në periudhën e kryerjes së kësaj detyre, nuk mund të marrë pjesë në marrjen e vendimeve që janë në kompetencë të Këshillit Mbikëqyrës. Kryerësi i detyrës është lëndë regjistrimi në Regjistrin Qendror.

(4) Për anëtar të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës mund të emërohet personi i cili, krahas kushteve të përcaktuara në Ligjin për shoqëri tregtare i plotëson edhe kushtet në vijim:

a) ka arsim të lartë;

b) ka përvojë pune së paku prej pesë vjetësh në sferën e drejtësisë, veprimtarisë bankare, kontabilitetit, sigurimit, menaxhimit me mjete dhe investim, menaxhimit me fonde të detyrueshme pensionale ose shërbime financiare nga të cilat tre vjet përvojë pune në pozicion udhëheqës;

v) nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në sferat e theksuara në pikën b) të këtij paragrafi;

g) nuk është i akuzuar për vepër penale nga sfera e financave dhe veprimtaria bankare dhe nxitje e falimentimit të personit juridik dhe

d) të posedojë reputacion me çka do të garantohet punë e sigurt dhe stabile e shoqërisë dhe fondit pensional.

(5) Agjencia me detyrë zyrtare siguron informata nga institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë për pikat v) dhe g) nga paragrafi (4) i këtij neni, ndërsa personi i huaj siguron vet informata të këtilla nga institucionet kompetente në vendin e huaj.

(6) Krahas kushteve nga paragrafi (4) i këtij neni, anëtari i Këshillit Drejtues të shoqërisë në mënyrë plotësuese duhet t'i përmbushë kushtet në vijim:

a) t'i njohë rregullat nga sfera e sigurimit pensional me financim kapital dhe

b) të dorëzojë program për punën e shoqërisë dhe të fondit pensional nga fushëveprimi i vet i punës.

(7) Së paku një nga anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të ketë dhënë provimin për këshilltar investues ose provim tjetër adekuat nga institucioni kompetent jashtë vendit.

(8) Gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Drejtues theksohet se cilët anëtarë janë përzgjedhur si anëtarë të pavarur të Këshillit Mbikëqyrës.

(9) Anëtarët e Këshillit Drejtues të shoqërisë, pas marrjes së lejes nga Agjencia duhet të punësohen në shoqëri.

(10) Agjencia për së afërmi i rregullon mënyrën dhe procedurën për zgjedhje të anëtarit të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë pensionale.

(11) Agjencia e shfuqizon përkatësisht e heq lejen për anëtar të Këshillit Drejtues ose Këshillit Mbikëqyrës, kur do të konstatojë se:

a) vendimi për lëshimin e lejes është miratuar në bazë të të dhënave të pavërteta dhe të pasakta;

b) në periudhën pas lëshimit të lejes fiton dëshmi të dokumentuar se anëtari nuk i plotëson më kushtet e këtij neni dhe

v) anëtari shkel rregullat për menaxhim të mirë korporativ, nuk punon në pajtim me programin e parashtruar për punë, nuk e zbaton politikën zyrtare të shoqërisë dhe të fondit pensional ose në mënyrë tjetër i rrezikon interesat e anëtarëve të fondit pensional.”

Neni 10

Neni 21-a ndryshohet si vijon:

“(1) Shoqëria obligohet që të ketë njësi të veçantë organizative për revizion të brendshëm i cili për punën e vet përgjigjet para Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë.

(2) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni bën kontroll të përhershëm dhe të plotë të ligjshmërisë dhe azhurimit të punës së shoqërisë, veçanërisht të menaxhimit me mjetet e fondit të detyrueshëm pensional, nëpërmjet, por duke mos u kufizuar në:

a) vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efikasitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm;

b) vlerësimin e vënies së sistemit informativ;

v) vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së raporteve financiare të shoqërisë dhe fondit të detyrueshëm pensional;

g) kontrollin e saktësisë, besueshmërisë dhe njoftimit me kohë në pajtim me ligjet, aktet nënligjore nga sfera përkatëse;

d) përcjelljen e respektimit të rregullave, politikave dhe procedurave për sferën e punës së shoqërisë, duke i përfshirë edhe politikat për menaxhim me rrezikun dhe kodin etik të shoqërisë;

gj) vlerësimin e sistemeve për parandalim të larjes së parave;

e) vlerësimin e shërbimeve që shoqëria i fiton nga bashkëpunëtorët e huaj dhe

zh) vlerësimin e efikasitetit të përgjithshëm të punës së shoqërisë.

(3) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni përgatit plan vjetor të punës për vitin e ardhshëm në të cilin detyrimisht theksohet lënda e revizionit me përshkrim të përmbajtjes së revizionit të planifikuar në sfera të caktuara dhe radhitje të kontrolleve gjatë vitit me kohëzgjatje të planifikuar për realizim të kontrolleve. Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë e miraton planin vjetor për punë dhe ia dorëzon Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tij.

(4) Njësia organizative nga paragrafi (1) i këtij neni përgatit raport për punën e saj gjatë vitit paraprak dhe e dorëzon për miratim në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë dhe njëkohësisht e dorëzon në Agjenci, më së voni deri më 31 mars.

(5) Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë raportin e miratuar nga paragrafi (4) i këtij neni, ia dorëzon Kuvendit të aksionarëve të shoqërisë dhe njëkohësisht ia dorëzon Agjencisë.

(6) Personi i punësuar në njësinë organizative nga paragrafi (1) i këtij neni, kryen punë kryesisht nga revizioni i brendshëm."

Neni 11

Në nenin 39-b paragrafi (1) në fjalinë e dytë pas fjalës "fond" shtohen fjalët: "dhe kërkesë për regjistrim në fondin e detyrueshëm pensional në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale".

Neni 12

Në nenin 39-v paragrafi (1) pika gj), ndryshohet si vijon:

"gj) për të gjithë personat të cilët do të ishin themelues, kopje të vërtetuara nga statutet ose akte tjera themeluese dhe ekstrakt nga organi kompetent në të cilin janë regjistruar emra dhe adresa të anëtarëve të këshillave drejtues dhe kopje të vërtetuara të tre raporteve të fundit financiare të reviduara nga revizori i jashtëm i autorizuar, si dhe çdo dëshmi plotësuese e nevojshme për të treguar se janë plotësuar kushtet nga neni 15 i këtij ligji;" .

Pika e) ndryshohet si vijon:

"e) dokumentet me të cilat vërtetohet se në datën e parashtrimit të kërkesës, themeluesit të cilët do të mbajnë 51% të kryegjësë themelore të shoqërisë kanë përvojë të madhe në menaxhim me mjete;" .

Në pikën zh) fjalët: "kapitali themelues" zëvendësohet me fjalët: "kryegjëja themelore".

Në pikën z) pas fjalës "përvojë" shtohen fjalët: "me rekomandime".

Pika k) ndryshohet si vijon:

"k) prospekti informativ për fondin e detyrueshëm pensional dhe programi për strategji investuese të fondit të detyrueshëm pensional dhe "

Në paragrafin (2) fjalët: "Në afat prej 30 ditësh nga dita e" zëvendësohen me fjalën: "Pas".

Në paragrafin (3) pika a) ndryshohet si vijon:

"a) të kërkojë informatë nga Drejtoria për Parandalimin e Larjes së Parave dhe financimit të terrorizmit, ose institucionit adekuat jashtë vendit dhe t'u drejtohet organeve dhe institucioneve tjera kompetente, rregulluese dhe të supervizionit në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit dhe".

Neni 13

Në nenin 39-g paragrafi (1) pika a) fjalët: " paguhet kapitali themelues i përcaktuar" zëvendësohen me fjalët: "paguar kryegjëja themelore e përcaktuar".

Neni 14

Në nenin 39-e paragrafi (1) fjalët: "kopjet e vërtetuara të akteve themeluese dhe statutit" zëvendësohen me fjalët: "kopje e vërtetuar e statutit".

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4) si vijojnë:

“(3) Pas plotfuqishmërisë së lejes për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional Agjencia e regjistron fondin e detyrueshëm pensional në regjistrin për fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe i përcakton numër identifikues.

(4) Regjistrimi i fondit të detyrueshëm pensional në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e regjistrimit në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale”.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (5).

Neni 15

Në nenin 39-zh paragrafi (1) fjala ”paraprake” shlyhet.

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

“(3) Agjencia i përcakton mënyrën dhe procedurën e lëshimit të lejes nga paragrafi (1) i këtij neni.”

Neni 16

Në nenin 39-z pas paragrafit (5) shtohet paragrafi i ri (6), si vijon:

“(6) Pas heqjes së lejës për menaxhim me fond të detyrueshëm pensional, për shoqërinë e cila menaxhon me atë fond pensional në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat për likuidim të shoqërive nga Ligji për shoqëri tregtare ose dispozitat nga Ligji për falimentim.”

Neni 17

Pas nenit 39-x shtohen gjashtë nene të reja 39-i, 39-j, 39-k, 39-ll, 39-l, 39-m, si vijojnë:

“Neni 39 – i

Shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale mund të bashkohet vetëm me shoqëri tjetër për menaxhimin me fonde të detyrueshme pensionale.

Neni 39-j

(1) Me bashkim të shoqërive nga neni 39-i dhe nga ky ligj themelohet shoqëri e re.

(2) Shoqëria e re themelohet në bazë të lejës së lëshuar nga Agjencia, ndërsa pas themelimit, nga Agjencia fiton lejen për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional.

(3) Për shkak të marrjes së lejës për themelim të shoqërisë të re për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, shoqëritë ekzistuese i parashtrojnë Agjencisë kërkesë me dokumentacionin e theksuar në paragrafin (5) të këtij neni dhe plan afarist i cili i përmban hollësitë për të gjitha aktivitetet dhe provizionet që do të paguhen në pajtim me këtë ligj. Kërkesa për leje për menaxhim me fond të detyrueshëm pensional dhe kërkesa për regjistrimin e fondeve të detyrueshme pensionale në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetre pensionale dorëzohet së bashku me kërkesën për leje për themelim të shoqërisë.

(4) Kërkesat nga paragrafi (3) i këtij neni, dorëzohen të nënshkruara nga nënshkruar të autorizuar të shoqërive ekzistuese për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale të cilët do të ishin themelues të shoqërisë së re. Formularët dhe përmbajtjen e kërkesave e përcakton Agjencia.

(5) Me kërkesat nga paragrafi (3) i këtij neni, shoqëritë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale duhet t'i dorëzojnë dokumentet, si vijojnë:

- a) vendimin për bashkim të miratuar nga organi kompetent për secilën shoqëri;
- b) marrëveshjen për bashkim të shoqërive;
- v) planin organizues dhe financiar për implementimin e shoqërisë së re;
- g) emrin e shoqërisë së re dhe të fondit të ri pensional;
- d) informatat për atë se a janë aksionarët persona të ndërlidhur;

gj) dokumentet për gjendjen financiare të aksionarëve të çdo shoqërie, për të gjitha vitet nga themelimi i saj, ndërsa më së shumti për periudhë prej pesë vjetësh e cila i paraprin datës së parashtrimit të kërkesës, duke i përfshirë edhe dokumentet me të cilat vërtetohet se asnjëri nga aksionarët nuk ka tatime dhe kontribute për sigurim social të papaguara;

e) prospektin e reviduar informativ për fondin e ri të detyrueshëm pensional;

zh) projektstatutin e fondit të ri të detyrueshëm pensional në të cilin theksohen kompensimet e planifikuara;

z) projekt marrëveshjen me ruajtësin e pronës për fondin e ri të detyrueshëm pensional dhe hollësitë për ndërprerje të marrëveshjeve ekzistuese;

x) emrat e anëtarëve të propozuar në Këshillin Drejtues dhe Mbikëqyrës, nëse këta persona nuk janë pjesë e shoqërive të cilat bashkohen dhe informatat nga neni 39-v paragrafi (1), pika z) të këtij ligji;

i) të dhënat për persona të cilët do të jenë në pozita udhëheqëse dhe persona të tjerë të cilët propozohet të jenë përgjegjës për vendimet investuese, revizion të brendshëm, llogari individuale, marketing dhe kontroll të agjentëve;

j) programin për strategjinë investuese të fondit të ri të detyrueshëm pensional dhe

k) dokumentet tjera të cilat i përcakton Agjencia.

(6) Agjencia jep leje për themelim të shoqërisë së re për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional dhe leje për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional, në bazë të dokumenteve nga paragrafi (5) të këtij neni dhe pas plotësimit të kushtëve nga ky ligj.

(7) Pas plotfuqishmërisë së lejes për menaxhim me fondin e detyrueshëm pensional, Agjencia e regjistron fondin e detyrueshëm pensional në Regjistrin për fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe i cakton numër identifikues.

(8) Regjistrimi i fondit të detyrueshëm pensional në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, ka veprim juridik ndaj personave të tretë ditën e ardhshme nga dita e regjistrimit në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale.

(9) Shoqëria e re për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, është trashëgimtar juridik i dy shoqërive për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale të cilat e kanë themeluar.

(10) Agjencia më afërsisht e rregullon mënyrën e bashkimit të shoqërive nga neni 39-i i këtij ligji dhe fondeve pensionale nga neni 39-ll i këtij ligji.

Neni 39-k

Agjencia mund ta refuzojë kërkesën për bashkim të shoqërive për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, nëse:

a) kërkesa me dokumentacionin nuk i plotësojnë kushtet nga neni 6, 7, 10, 11, 12, 14, 15, 17, 18, 21-a, dhe 22 të këtij ligji;

b) dokumentet e deponuara me kërkesën ose informatat tjera tregojnë se cila do nga shoqëritë e cila bashkohet në periudhë prej 5 vjetësh para parashtrimit të kërkesës ka borxhe të mbetura në bazë të tatimeve dhe kontributeve të papaguara për sigurim social;

v) aksionet e cilës do shoqëri rrjedhin nga borxhi, kredia ose janë të ngarkuara në çfarëdo mënyre tjetër;

g) aktivitetet afariste të parashtruesve të kërkesës nuk garantojnë se shoqëria e re dhe fondet e detyrueshme pensionale me të cilat do të menaxhohet do të menaxhohen në interes më të mirë të anëtarëve dhe

d) me bashkim rrezikohen interesat e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale ose interes tjetër publik.

Neni 39-ll

(1) Fondet e detyrueshme pensionale bashkohen në të njëjtën kohë me shoqëritë, të cilat kanë menaxhuar me ato fonde pensionale dhe themelohet një fond i detyrueshëm pensional.

(2) Me bashkimin e fondeve të detyrueshme pensionale nga paragrafi (1) i këtij neni, fondi i ri pensional i merr të drejtat dhe obligimet nga fondet e detyrueshme pensionale të cilat janë bashkuar.

Neni 39-1

Para bashkimit të shoqërive nga neni 39-i të këtij ligji, shoqëritë i njoftojnë me shkrim të gjithë anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional për vendimin për bashkim. Pas bashkimit, shoqëria e re për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale i njofton të gjithë anëtarët e fondeve të detyrueshme pensionale për emrin e shoqërisë, emrin e fondit të ri të detyrueshëm pensional dhe u dorëzon kopje nga prospekti informativ, statuti i shoqërisë së re dhe statuti i fondit të ri të detyrueshëm pensional.

Neni 39-m

(1) Shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale mund të bashkohet vetëm me shoqërinë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale.

(2) Në rast të bashkimit të njëres shoqëri me shoqëri tjetër nga paragrafi (1) i këtij neni, fondi i detyrueshëm pensional, me të cilin menaxhon shoqëria e cila bashkohet me fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon shoqëria me të cilën bëhet bashkimi.

(3) Para bashkimit të fondeve të detyrueshme pensionale shoqëria me të cilën bëhet bashkimi i njofton me shkrim të gjithë anëtarët e fondeve të detyrueshme pensionale.

(4) Me bashkim të një fondi me fond tjetër të detyrueshëm pensional anëtarët dhe llogaritë individuale të fondit pensional i cili bashkohet transferohen në fondin pensional me të cilin bashkohet.

(5) Agjencia më afërsisht e përcakton mënyrën e bashkimit të shoqërive dhe të fondeve të detyrueshme pensionale.”

Neni 18

Neni 40 paragrafi (1) pas fjalës “kontribute” shtohet presje dhe fjalët:”të zvogëluara për kompensimet të cilat arkëtohen nga fondi i detyrueshëm pensional”.

Neni 19

Në nenin 45, paragrafi (2) pas fjalës ”fond” shtohen fjalët: ”dhe çdo ndryshimi të tij”.

Neni 20

Në nenin 46, paragrafi (2) në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohen fjalët: ”dhe regjistrohet në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.”

Neni 21

Në nenin 47 paragrafi (1), pika zh) ndryshohet si vijon:

“zh) mban Regjistër të agjentëve, Regjistër të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale dhe Regjistër të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale.”

Neni 22

Në nenin 49 paragrafi (4) fjalët:”prospekt informativ” zëvendësohen me fjalët:”raport statistikor”.

Neni 23

Në nenin 50 paragrafi (6) , pika v) ndryshohet si vijon:

“v) miraton plan financiar, raporte financiare dhe program vjetor për punën e Agjencisë dhe e përcjell realizimin e tyre;”.

Neni 24

Në nenin 53 paragrafi (6) , fjala "paregullsitë" zëvendësohet me fjalën "paligjshmëritë", kurse fjala: "parregullsi" zëvendësohet me fjalën "paligjshmëri".

Pas paragrafit (7) shtohet paragraf i ri (8), si vijon:

"(8) Procedurë për kundërvajtje nuk mund të ngritet as të mbahet nëse kanë kaluar më shumë se tre vjet nga dita kur është bërë kundërvajtja. Parashkrimi i ngritjes dhe mbajtjes të procedurës për kundërvajtje në çdo rast, fillon pas kalimit të pesë vjetëve nga dita kur është kryer kundërvajtja."

Paragrafi (8) bëhet paragraf (9).

Neni 25

Në nenin 56 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Agjencia, më së voni deri më 31 dhjetor të vitit rrjedhës, dorëzon plan financiar për vitin e ardhshëm në pajtim me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe i njëjti botohet në "Gazetën Zyrtare e Republikës së Maqedonisë". Agjencia, më së voni deri më 30 qershor në vitin rrjedhës, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë i dorëzon raporte financiare për vitin paraprak, të rishikuara nga revizori i jashtëm i autorizuar në pajtim me standardet ndërkombëtare për revizorë."

Në paragrafin (2) fjala: "buxheti" zëvendësohet me fjalët: "plani financiar".

Në paragrafin (3) në pikën a) fjalët: "2,5% të kontributeve të përgjithshme të paguara" zëvendësohen me fjalët: "0,8% të çdo kontributi të paguar".

Paragrafi (5) ndryshohet si vijon:

"Agjencia e ka llogarinë e vet në bankën afariste në Republikën e Maqedonisë."

Në paragrafin (6) fjalët: "Enti për Revizion Shtetëror i Republikës së Maqedonisë" zëvendësohet me fjalët: "revizori i jashtëm i autorizuar".

Neni 26

Pas nenit 56 shtohen dy nene të reja 56-a dhe 56-b, si vijojnë:

"Neni 56-a

Nëse gjatë vitit paraprak afarist Agjencia realizon tepricë të të ardhurave mbi harxhimet e realizuara, teprica e realizuar e mjeteve shpërndahet në fondin rezerv të Agjencisë, në shumë të përcaktuar me planin financiar të Agjencisë.

Neni 56-b

(1) Nëse gjatë vitit paraprak afarist, Agjencia realizon më shumë harxhime në raport me të ardhurat e realizuara, mungesa e mjeteve kompensohet nga fondi rezerv i Agjencisë.

(2) Mjetet e realizuara nga teprica e të hyrave ndaj të dalave, të ndara në fondin rezerv të Agjencisë, ruhen në llogari te banka afariste në Republikën e Maqedonisë."

Neni 27

Neni 60 ndryshohet, si vijon:

"(1) Pagesa e kontributeve për sigurim pensional dhe invalidor bëhet në pajtim me Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social .

(2) Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë i transferon kontributet e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogaritë e fondeve të zgjedhura të detyrueshme pensionale, menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej pesë ditësh pune nga pranimi i kontributeve, me kusht që në afatin e njëjtë të jenë pranuar edhe të dhëna adekuate në pajtim me ligjin, të cilat i mundësojnë Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë që ta kryejë atë obligim.

(3) Mjetet për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, të realizuara në bazë të pagesës me vonesë dhe jo të plotë të kontributit, transferohen në llogari individuale të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional.”

Neni 28

Në nenin 61 paragrafi (5), shtohet fjali e re si vijon: “Ky obligim pushon pas kalimit të 60 ditëve, nga nënshkrimi i marrëveshjes së përkohshme për anëtarësim.”

Neni 29

Pas nenit 64 shtohet neni i ri 64-a, si vijon:

“Neni 64-a

Agjencia mund ta anulojë regjistrimin e anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional në regjistrin e anëtarëve nëse:

- a) regjistrimi bazohet në të dhëna jo të sakta;
- b) me kërkesë të anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional i cili e ka shfuqizuar statusin e përcaktuar në bazë të nenit 131, paragrafi (2) të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor;
- v) në bazë të vendimit gjyqësor ose
- g) në raste tjera të cilat nuk janë në pajtim me ligjin.”

Neni 30

Në nenin 65 pas paragrafit (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

“(4) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, kur anëtari ose personi i siguruar i sistemuar përkohësisht do të fitojë të drejtë të pensionit invalidor në pajtim me nenin 139 të Ligji për sigurim pensional dhe invalidor, pensionin e përkohëshëm invalidor e paguan Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë, ndërsa mjetet nga llogaria individuale e anëtarit ngelin në fondin e detyrueshëm pensional, derisa anëtari nuk realizon të drejtë të pensionit të pleqërisë, pensionit invalidor ose falimjar.”

Neni 31

Në nenin 68 paragrafi (1) fjalët: “të paguara në Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë për të cilat Fondi” zëvendësohen me fjalët: “për të cilat Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë”.

Neni 32

Në nenin 69 në fjalinë hyrëse pas fjalëve: ”nevojat e“ shtohet fjala ”detyrueshëm”.

Në pikën b) fjalët: ”obliguesit e kontributit për sigurim pensional dhe invalidor” zëvendësohen me fjalët: “Drejtoria e të Hyrave Publike”.

Neni 33

Neni 70 ndryshohet si vijon:

“Fondi për Sigurim Invalidor dhe Pensional i Maqedonisë i përcakton mënyrën dhe procedurën e kryerjes të funksioneve të Fondit, të përcaktuara në nenin 69 të këtij ligji, me pajtimin paraprak nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.”

Neni 34

Neni 71 ndryshohet si vijon:

“Fondi për Sigurim Invalidor dhe Pensional i Maqedonisë obligohet që të sigurojë dhe të mbajë softuer për shpërndarje dhe transfer të kontributeve të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në llogari të fondeve të zgjedhura të detyrueshme pensionale.”

Neni 35

Në nenin 75 paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Për shkak të sigurimit të informimit të drejtë dhe objektiv të opinionit shoqëria e cila menaxhon me fond pensional të detyrueshëm obligohet që çdo material për marketing t’ia dorëzojë për leje Agjencisë dhe nuk guxon të shpallë ose emetojë material të pajeluar për marketing. Nëse përfaqësuesi i shoqërisë jep deklaratë me gojë ose intervistë për të cilat nuk ka qenë i njoftuar paraprakisht, shoqëria obligohet që deklaratën e dhënë ose intervistën e mediumit adekuat t’ia dorëzojë Agjencisë, në afat prej tre ditësh pas shpalljes së tyre. Agjencia miraton udhëzime për përmbajtjen e reklamave dhe për materialin tjetër promovues të fondeve të detyrueshme pensionale dhe të shoqërive të cilat menaxhojnë me to.”

Neni 36

Në nenin 76 paragrafi (1) shlyhet.

Neni 37

Në nenin 77 paragrafi (6) pika a) pas fjalës ”Maqedonisë” shtohen fjalët: ”ose nëse është shtetas i huaj ta ketë të rregulluar të statusin e shtetasit të huaj në Republikën e Maqedonisë në pajtim me ligjin.”

Në pikën v) lidhëza ”dhe” zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën g) shlyhet pika dhe shtohet lidhëza ”dhe”.

Pas pikës g) shtohet pikë e re d), si vijon:

”d) të mos jetë i punësuar në Fondin për Sigurim Invalidor dhe Pensional të Maqedonisë, Fondin për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë, Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë, Drejtorinë për të Hyra Publike dhe Agjencitë për Punësime të Përkohshme.”

Në paragrafin (7) fjalia e dytë ndryshon si vijon: “Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, obligohet që të parashtrojë kërkesë në emër të agjentit për regjistrimin e tij në regjistrin e agjentëve, nëse personi i plotëson kushtet dhe të parashtrojë kërkesë për shlyerje të agjentit nga regjistri i agjentëve nëse nuk e plotëson ndonjë nga kushtet e paragrafit (6) të këtij neni.”

Paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

“Agjencia zbaton procedurë për shlyerje nga regjistri i agjentëve, të agjentit i cili nuk i respekton dispozitat e këtij ligji dhe Ligjit për sigurim pensional me financim kapital vullnetar. Drejtori i Agjencisë merr vendim për shlyerjen e agjentit kundër të cilit agjenti ka të drejtë ankese te Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë. Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.”

Neni 38

Në nenin 78 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Në rast kur shoqëria e cila menaxhon me fond të detyrueshëm pensional nëpërmjet të punësuarit të vet, përfaqësuesit, agjentit ose personit të ndërlidhur me atë shoqëri, ushtron ndikim te personi i gjinisë mashkullore më i moshuar se 50 vjet ose personi i gjinisë femërore më e moshuar se 45 vjet që të antarësohet në fondin e detyrueshëm pensional, shoqëria duhet të jetë në gjendje të dëshmojë se gjatë kohës së lidhjes së marrëveshjes për antarësim, nuk ka qenë e mundshme të supozohet në mënyrë të arsyeshme se antarësimi i atij personi në atë fond të detyrueshëm pensional është në kundërshtim me interesat e tij.”

(2) Në paragrafin (3) fjalët: ”paragrafët (1) dhe (2)” zëvendësohen me fjalët: ”paragrafi (1).”

Neni 39

Në nenin 89 paragrafi (1) pika b). në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohet lidhëza ”ose”.

Pas pikës b) shtohet pikë e re v), si vijon:

“v) kombinimi i opsioneve të theksuara në pikat a) dhe b) të këtij paragrafi.”

Neni 40

Neni 94 ndryshohet si vijon:

“(1) Secila shoqëri ose shoqëri për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, obligohet që të ketë prospekt informativ për fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon. Prospekti informativ përmban të dhëna të plota të sakta dhe objektive për fondin e detyrueshëm pensional dhe shoqërinë e cila menaxhon me atë fond, të cilat janë të nevojshme që anëtarë potencial të marrë vendim për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional, dhe atë:

- a) emrin dhe selinë e shoqërisë dhe fondit me të cilin menaxhon;
- b) emrat e anëtarëve të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës të shoqërisë;
- v) emrat dhe adresat e aksionarëve dhe pjesëmarja e tyre në kryegjënë themelore të shoqërisë;
- g) emrin dhe selinë e ruajtësit të pronës dhe të dhënat për ndryshimet eventuale të ruajtësit të pronës të bëra në vitin e kaluar dhe shkaqet për ndryshimet e tilla;
- d) të dhënat për revizorin e fondit të detyrueshëm pensional dhe të shoqërisë;
- gj) parimet themelore të investimit për periudhën nga paragrafi (2) i këtij neni dhe vetkufizimet gjatë investimit përveç kufizimeve të caktuara në këtë ligj;
- e) përgjegjësinë gjatë marrjes së vendimeve investuese;
- zh) kompensimet, provizionet dhe të gjitha harxhimet tjera të cilat paguhen nga antarët e fondit të detyrueshëm pensional ;
- z) mënyrën e antarësimit dhe kalimit;
- x) mënyrën e njoftimit të anëtarëve;
- i) të drejtën e pensionit;
- j) portfolion e fondit të detyrueshëm pensional;
- k) numrin e anëtarëve të fondit të detyrueshëm pensional;
- ll) neto vlerën të mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional dhe
- l) të dhënat tjera për punën e shoqërisë dhe menaxhimin me fondin e detyrueshëm pensional që mund t'i përcaktojë Agjencia për shkak të sigurimit të transparencës.

(2) Prospektin informativ nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetre pensionale obligohet që më së voni deri më 31 mars të çdo viti rrjedhës, me gjendje të 31 dhjetorit të vitit të kaluar, ta publikojë në veb faqen e shoqërisë dhe në një nga gazetatat ditore me tirazh më të madh që shpërndahen në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në afat prej 15 ditësh nga regjistrimi i fondit të detyrueshëm pensional në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, obligohet që ta shpallë prospektin informativ me të dhëna nga paragrafi (1), pikat a), b), v), g), d), gj), e), zh), z), x), i) dhe l)) të këtij neni.

(4) Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, obligohet që me kërkesë të antarit të fondit të detyrueshëm pensional, t'ia dorëzojë prospektin informativ dhe statutin e fondit të detyrueshëm pensional, me të cilin menaxhon dhe të njëjtat t'ia japë për kontroll çdo personi i cili do të paraqitet për antarësim në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon ajo shoqëri.

(5) Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale obligohet që me kërkesë të personit, ta njoftojë nëse është antar i fondit të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon, si dhe për të drejtat të cilat dalin nga antarësimi."

Neni 41

Neni 95 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale obligohet që rregullisht, ndërsa së paku një herë në vit t'i informojë në formë të shkruar antarët e fondit të detyrueshëm pensional për gjendjen e mjeteve në llogaritë e tyre individuale, për datat

e pagesës së kontributeve dhe të transferimit të mjeteve për antarin e atij fondi gjatë periudhës përkatëse dhe për transformimin e kontributeve dhe mjeteve të transferuara në njësitë e kontabilitetit. Ky njoftim, me pajtimin paraprak të anëtarit, në vend të formës me shkrim mund të dorëzohet edhe në formë elektronike.”

Neni 42

Neni 96 ndryshohet si vijon:

“(1) Shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale obligohet që Agjencisë t’ia dorëzojë informatat në vijim:

a) raportet e pareviduara tremujore financiare dhe raportet e reviduara dhe të pareviduara vjetore financiare për shoqërinë ose shoqërinë për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale;

b) raportet e pareviduara, tremujore, themelore financiare, dhe raportet plotësuese dhe raportet e pareviduara dhe të reviduara vjetore financiare dhe raportet plotësuese për fondin e detyrueshëm pensional;

v) të dhënat më të hollësishme për fitim dhe transfer të mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional me theksim të çdo mjeti individual, datën dhe çmimin e transakcionit dhe personin juridik i cili e realizon shërbimin e letrave me vlerë;

g) të dhënat për harxhimet për Agjencinë, rojtarin e pronës, Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë, transakcionet, marketingun, agjentët dhe harxhime të tjera;

d) të dhëna për aksionarët e shoqërisë ose shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale duke përfshirë emra dhe adresa;

gj) emrat e anëtarëve të organeve të menaxhimit dhe të punësuarve në shoqërinë ose shoqërinë për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe lartësinë e kompensimeve për punën e tyre;

zh) informatën për njoftimet e dorëzuara anëtarëve nga neni 95 paragrafët (1) dhe (3) të këtij ligji;

z) të dhëna më të hollësishme për numrin e antarëve të fondit të detyrueshëm pensional gjatë vitit; numrin e antarëve të cilët janë anëtarësuar në fondin e detyrueshëm pensional; numrin e atyre që kane kaluar në fonde tjera të detyrueshme pensionale, numrin e antarëve të vdekur dhe numrin e antarëve të pensionuar;

x) raportet nga kontrolliet e brendshme dhe revizionet e brendshme; dhe

i) të dhëna të tjera të përcaktuara nga Agjencia.

(2) Raportet e pareviduara financiare nga paragrafi (1) pika a) dhe b) të këtij neni, dorëzohen në afat prej një muaji pas përfundimit të periudhës me të cilën kanë të bëjnë raportet, ndërsa raportet e reviduara financiare nga paragrafi (1) pikat a) dhe b) të këtij neni, dorëzohen në afat prej tre muajsh pas përfundimit të periudhës me të cilën kanë të bëjnë raportet.

(3) Të dhënat nga paragrafi (1) pika v) e këtij neni, dorëzohen për çdo datë të vlerësimit më së voni ditën e ardhshme punuese.

(4) Të dhënat nga paragrafi (1) pika g) dhe z) të këtij neni, dorëzohen një herë në muaj, më së voni deri në ditën e 5-të të muajit për muajin paraprak.

(5) Të dhënat nga paragrafi (1) pikat g) dhe gj) të këtij neni dorëzohen një herë në vit, më së voni deri në ditën e 15-të nga përfundimi i vitit afarist.

(6) Të dhënat nga paragrafi (1) pika zh) të këtij neni, dorëzohen në afat prej një muaji nga përfundimi i periudhës me të cilën kanë të bëjnë të dhënat.

(7) Raportet nga paragrafi (1) pika x) të këtij neni, dorëzohen për çdo tremujorësh, më së voni deri në ditën e 5-të të muajit për tremujorshin paraprak.

(8) Agjencia për së afërmi i përcakton llojin dhe periudhën me të cilën kanë të bëjnë të dhënat, mënyrën dhe formën e paraqitjes së të njëjtave dhe procedurën për dorëzimin e tyre.”

Neni 43

Në nenin 98 paragrafi (1), pika a) ndryshohet si vijon:

“a) kompensimi nga kontributi si përqindje nga secili kontribut i paguar në fondin e detyrueshëm pensional, para transformimit të mjeteve në njësitë e kontabilitetit. Lartësinë e kompensimit e përcakton shoqëria por ajo nuk mund të tejkalojë 4% nga çdo kontribut i paguar;”.

Në paragrafin (3) pika b) , lidhëza ”ose” shlyhet.

Pas pikës v) shtohen dy pika të reja g) dhe d), si vijojnë:

“g) nëse anëtari nuk ka mjete në llogarinë individuale ose

d) në rast të lidhjes ose bashkimit të shoqërisë e cila duhet të bëjë transfer të mjeteve nga njëri fond në fond tjetër të detyrueshëm pensional, në periudhën prej 180 ditësh nga lidhja ose bashkimi.”

Paragrafët (4), (5) dhe (6) shlyhen.

Neni 44

Në nenin 100 paragrafi (2) pas fjalës ”shpall” shtohen fjalët:”në ueb faqen e shoqërisë, ose shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale”.

Neni 45

Në nenin 102 paragrafi (4), përqindja ”0,8%” zëvendësohet me përqindjen ”0,1%”.

Neni 46

Në nenin 105 paragrafi (1), pika a) ndryshohet si vijon:

“a) depozitat në banka të cilat kanë leje të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, nëse bartin interes dhe maturohen në afat i cili nuk është më i gjatë se një vit;”.

Pika k) ndryshohet si vijon:

“k) dokumente për pjesëmarrje, aksione dhe instrumente tjera të dhëna nga fonde të autorizuar investuese me seli në shtetin-anëtar të UE-së ose OECD-së, që kanë investuar kryesisht në instrumente të cilat kuotojnë në bursat e atyre shteteve dhe”

Në pikën ll) presja dhe fjalët: ”me mendimin paraprak të Komisioni për Letra me Vlerë” shlyhen.

Neni 47

Neni 106 ndryshohet si vijon:

“(1) Mjetet e fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në letra me vlerë të botuesit të njëjtë më së shumti deri 10% nga vlera nominale e letrës individuale me vlerë e botuar nga ai botues, përveç në rast të obliguesve dhe letrave tjera me vlerë të botuara ose për të cilat garanton Republika e Maqedonisë ose ndonjëri nga shtetet-anëtare të UE-së ose OECD-së.

(2) Më së shumti 5% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në instrumente, përveç depozitave dhe certifikatave për depozit të botuara nga subjekti i njëjtë i cili nuk është themeluar nga shteti dhe është regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë ose në vendin-anëtar të UE-së ose të OECD-së, me çrast më së shumti deri 7,5% nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në instrumente, përveç depozita dhe certifikata për depozit, të subjekteve të lidhura ndërmjet veti në këtë mënyrë.

(3) Më së shumti 3% nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në depozita dhe certifikata për depozit në një bankë e cila ka leje të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, përveç në depozita dhe certifikata për depozit në bankë e cila është ruajtëse e pronës së fondit të detyrueshëm pensional ku mund të investohet së paku 2% nga

mjetet e fondit të detyrueshëm pensional. Më së shumti deri më 5% nga mjetet e fondit të obligueshëm pensional mund të investohen në depozita dhe certifikata për depozit të bankave të ndërlidhura ndërmjet veti..

(4) Agjencia mund të përcaktojë kufizime të investimeve të llojeve të ndryshme të instrumenteve të ndryshme nga kufizimet e përcaktuara në nenin 107 të këtij ligji, të cilat do të vlejné në afat të përcaktuar nga Agjencia, por jo më të gjatë se pesë vjet. Kufizimet nuk mund hiqen plotësisht ose pjesërisht pa njoftim paraprak me shkrim nga secila shoqëri e cila menaxhon me fond të detyrueshëm pensional, më së paku një vit para heqjes.”

Neni 48

Në nenin 107 paragrafi (1) pika a) përqindja “30%” zëvendësohet me përqindjen “50%”, kurse fjalia e dytë ndryshohet si vijon: “Në suaza të këtij kufizimi më së shumti 30% nga vlera e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në instrumente të theksuara në nenin 105 paragrafi (1) pikat i), j) dhe k) të këtij ligji.”

Në pikën v) në fund të fjalisë pikëpresja shlyhet dhe shtohen fjalët: ”nga të cilat më së shumti 30% e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në instrumentet nga neni 105 paragrafi (1) pika a) të këtij ligji”.

Neni 49

Në nenin 109, paragrafi (4) fjala ”gjashtë” zëvendësohet me fjalën ”tetëmbëdhjetë”.

Neni 50

Në nenin 110 pika v), në fund të fjalisë pika shlyhet dhe shtohen fjalët: ”përveç garancive për ngarkim me borxh nga neni 113 paragrafi (1) të këtij ligji”.

Neni 51

Në nenin 115 paragrafi (2) numri ”(1)” zëvendësohet me numrin ”(2)”.

Neni 52

Në nenin 116 paragrafi (2), pika a) ndryshohet si vijon:

“a) të ketë mjete të veta minimale prej 20 000 000 eurosh në kundërvlerë me denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me definicionin për mjete personale në Ligjin për bankat;”

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), si vijojnë:

“(3) Nëse banka pushon të plotësojë ndonjërin nga kushtet e paragrafit (2) të këtij neni, në periudhë deri sa është ruajtës i pronës së fondit të detyrueshëm pensional, obligohet që menjëherë t'i informojë shoqërinë e cila menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional dhe Agjencinë dhe të ndërmarrë aktivitete për harmonizim me dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni, në periudhë jo më të gjatë se tre muaj nga dita kur ka pushuar ta plotësojë ndonjërin nga kushtet.

(4) Banka e cila e kryen punën e ruajtësit të pronës, duhet të ketë njësi të veçantë organizative për kryerjen e atyre punëve.”

Neni 53

Në nenin 130 paragrafi (1) pas numrit ”135”, shtohet numri “135-a”.

Neni 54

Në nenin 132 paragrafi (1) pas numrit “135”, shtohet numri “135-a”.

Pas paragrafit (6) shtohet paragraf i ri (7), si vijon:

“(7) Nëse nuk ekzistojnë baza për zbatimin e procedurës për barazim me thirrjen e kryerësit, personi i autorizuar për kontroll, kryerësit ia dorëzon me postë urdhërpagesën me procesverbalin nga kundërvajtja e konstatuar. Procedura për barazim, llogaritet se është e zbatuar dhe personi i autorizuar për kontroll mund të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje nëse kryerësi:

- a) e ka pranuar me postë urdhërpagesën por nuk e ka paguar në afatin e paraparë ose
- b) e ka kthyer urdhërpagesën me shënimin se nuk dëshiron ta pranojë.”

(3) Paragrafi (7) bëhet paragraf (8).

Neni 55

Në nenin 133 paragrafi (1) fjalët: “deri në 50 000” shlyhen.

Pika 2 ndryshohet si vijon:

“2) nuk mundëson qasje te librat, dokumentet dhe evidenca tjetër e personit të autorizuar i cili kryen kontroll në emër të Agjencisë, në pajtim me nenin 53 paragrafi (3) i këtij ligji.”

Pas pikës 2 shtohet pika e re 2-a, si vijon:

“2-a) nuk i mënjanon paligjshmëritë, në pajtim me nenin 53 paragrafi (6) të këtij ligji.”

Pika 11 ndryshohet si vijon:

“11) investon mjete nga fondi i detyrueshëm pensional, në kundërshtim me instrumentet dhe kufizimet e parapara në nenet 105, 106, 107 dhe 108 të këtij ligji.”

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 40 000 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim të fondeve të detyrueshme pensionale, nëse:

- 1) kryen veprimtari të cilat nuk janë të parapara në nenin 7 paragrafi (1) të këtij ligji;
 - 2) nuk e zmadhon dhe mban kryegjënë në pajtim me nenin 10, paragrafët (2), (4) dhe (5) të këtij ligji;
 - 3) nuk i mban dhe nuk i zmadhon mjetet e veta të llogaritura sipas metodologjisë së përcaktuar nga Agjencia, në pajtim me nenin 10 paragrafët (6) dhe (7) të këtij ligji;
 - 4) nuk mban mjete likuide në pajtim me nenin 10 paragrafi (8) të këtij ligji;
 - 5) nuk e paguan kryegjënë themelore në mënyrë të përcaktuar me nenin 11 të këtij ligji;
 - 6) kryegjëja themelore rrjedh nga burime në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji;
 - 7) nuk kryen harmonizim adekuat në afat prej gjashtë muajsh, në pajtim me nenin 14, paragrafi (5) i këtij ligji;
 - 8) nuk kërkon pajtim për çdo përfitim ose bartje të aksioneve në pajtim me nenin 16, paragrafi (1) i këtij ligji;
 - 9) blen aksione nga shoqëria tjetër për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, ose riorganizohet në kundërshtim me nenin 16 paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji;
 - 10) kryen ndryshime pa lejen e Agjencisë, në pajtim me nenin 39-zh të këtij ligji dhe
 - 11) kryen bashkim në kundërshtim me nenet 39-i, 39-j dhe 39-l të këtij ligji.”
- Në paragrafin (5) fjalët: “deri në 5 000” shlyhen.

Neni 56

Në nenin 134 paragrafi (1), fjalët: “deri në 30 000” shlyhen.

Në pikën 2 pas numri: “21” shtohen fjalët: “paragrafi (2)”.

Pika 8 ndryshohet si vijon:

“8) nuk i transferon në Fondin për Sigurim Invalidor dhe Pensional të Maqedonisë, kontributet e paguara për anëtarin e fondit të detyrueshëm pensional, në pajtim me nenin 66-a paragrafi (1) i këtij ligji.”

Në pikën 12 pas numrit “96” shtohen fjalët: “paragrafi (1)”.

Në pikën 15 fjalët: “nenet 106 dhe 109” zëvendësohen më fjalët: “neni 109”.

Në paragrafin (3) fjalët: “deri në 30 000” shlyhen.

Para pikës 1 shtohet pika e re 1, si vijon:

“1) nëse nuk themelon njësi organizative në pajtim me nenin 21-a, paragrafi (1) i këtij ligji;”.

Pika 1 bëhet pika 2.

Në paragrafin (5) fjalët: ”deri në 3 000 ”shlyhen.

Neni 57

Në nenin 135 paragrafi (1), fjalët: ”deri në 10 000” shlyhen.

Pika 1, ndryshohet si vijon:

“1) fillon me aktivitete të menaxhimit me fondin e detyrueshëm pensional, marketingut dhe hulumtimit të mendimit publik, në kundërshtim me kushtet nga neni 39-e paragrafi (5) i këtij ligji;”.

Pika 5 ndryshohet si vijon:

”5) jep informata të gabuara dhe të pasakta për fondin e detyrueshëm pensional ose për shoqatën e cila menaxhon me atë fond ose jep deklarata ose parashikime për rezultatet e ardhshme investuese për fondin e detyrueshëm pensional, ose nuk vepron sipas aktvendimit të Agjencisë sipas nenit 75 paragrafët (1), (2) dhe (5) të këtij ligji;”.

Në pikën 7) fjalët: ”(3) dhe (4)” zëvendësohen me fjalët: ” dhe (3)”.

Pika 8 ndryshohet si vijon:

“8) nuk ia dorëzon prospektin informativ dhe statutin anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional, nuk ia jep për shikim personit dhe nuk e njofton personin, në pajtim me nenin 94 paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji.”

Në paragrafin (3) fjalët: “deri në 2 000” shlyhen.

Neni 58

Pas nenit 135 shtohet neni i ri 135-a, si vijon:

“135-a

“(1) Gjobë në shumë prej 5 000 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, ose shoqërisë për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, nëse:

1) nuk i dorëzon për miratim Agjencisë ose boton material të pajeluar për marketing, nuk e dorëzon në afat, nuk e njofton Agjencinë për deklaratën me gojë ose intervistën në medium adekuat, në pajtim me nenin 75 paragrafi (4) i këtij ligji;

2) nuk vepron në pajtim me nenin 77, paragrafi (7) i këtij ligji:

3) nuk e njofton menjëherë Agjencinë për vlerën neto të mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional dhe vlerën e njësisë së kontabilitetit të fondit të detyrueshëm pensional, në pajtim me nenin 85 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe

4) nuk i dorëzon informata dhe të dhëna Agjencisë ose nuk dorëzon të dhëna dhe informata, në afatet e parapara me nenin 96 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 5 000 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje shoqërisë për menaxhim me fonde të detyrueshme pensionale, nëse:

1) nuk përgatit plan vjetor për punë, raport për punën e vet dhe nuk ia dorëzon Agjencisë, në pajtim me nenin 21-a paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji.

Neni 59

Në nenin 136 paragrafi (1) fjalët:”deri në 50 000” shlyhen.

Pas pikës 1 shtohet pikë e re 1-a, si vijon:

“1-a) nuk i mënjanon paligjshmëritë, në pajtim me nenin 53 paragrafi (6) i këtij ligji;”.

Në paragrafin (3) fjalët: ”deri në 5 000” shlyhen.

Neni 60

Në nenin 136-a paragrafi (1) fjalët: "1 500 deri" shlyhen.
Në pikën 1 numri "(4)" zëvendësohet me numrin "(3)".
Pika 2 shlyhet.

Neni 61

Neni 136-b, ndryshohet si vijon:

"Gjobë në shumë prej 1 000 eurosh në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, nëse:

1) nuk u përmbahet obligimeve dhe përkufizimeve të parapara në nenin 77, paragrafët (4) dhe (5) të këtij ligji."

Neni 62

Në nenin 136-v paragrafi (1) fjalët: "deri në 30 000" shlyhen.
Në pikën 1 fjala "pagan" zëvendësohet me fjalën "transferon".
Në paragrafin (2) fjalët: "deri në 3 000" shlyhen.

Neni 63

Në nenin 136-g paragrafi (1) fjalët: "deri në 3 000" shlyhen.

Neni 64

Në nenin 136-d paragrafi (1) fjalët: "deri në 30 000" shlyhen.
Në paragrafin (2) fjalët: "deri në 3 000" shlyhen.

Neni 65

Shoqëritë ekzistuese për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, obligohen që të hamonizohen me dispozitat e nenit 9, paragrafët (7) dhe (8) të këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 66

Agjencia i regjistron fondet ekzistuese të detyrueshme pensionale në regjistrin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, dhe u përcakton numër identifikues në afat prej 15 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 67

Në ditën e hapjes të llogarisë nga neni 25 paragrafi (4) i këtij ligji, mjetet e Agjencisë nga llogaria e cila udhëhiqet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, transferohen në llogari të hapur në bankë afariste në Republikën e Maqedonisë.

Neni 68

Nëse shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde të detyrueshme dhe vullnetare pensionale nuk dëshmon se gjatë lidhjes së marrëveshjes për anëtarësim me personin nga neni 38 paragrafi (1) i këtij ligji, nuk ka qenë e mundur të supozohet në mënyrë të arsyeshme se anëtarësimi i atij personi është në kundërshtim me interesat e tij, personi i cili ka lidhur marrëveshje për anëtarësim para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mundet në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji t'i parashtrojë Agjencisë kërkesë për anulimin e regjistrimit të tij nga Regjistri i anëtarëve.

Nëse shoqëria ose shoqëria për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, nuk dëshmon se gjatë lidhjes të marrëveshjes për antarësim me personin nga neni 38 paragrafi (1) i këtij ligji, nuk ka qenë e mundur të supozohet në mënyrë të arsyeshme se

anëtarësimi i atij personi është në kundërshtim me interesat e tij, personi i cili ka lidhur marrëveshje për anëtarësim pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mundet në afat prej një viti nga lidhja e marrëveshjes për anëtarësim, t'i parashtrojë Agjencisë kërkesë për anulimin e regjistrimit të tij nga Regjistri i anëtarëve.

Neni 69

Lartësia e kompensimit të kontributeve nga neni 43 paragrafi (1) i këtij ligji, që e arkëtojnë shoqëritë ose shoqëritë për menaxhim me fonde pensionale të detyrueshme dhe vullnetare, për vitin 2010 nuk mund të tejkalojë 5,5% nga secili kontribut i paguar edhe për vitin 2011 nuk mund të tejkalojë 4,5% nga secili kontribut i paguar.

Neni 70

Lartësia e kompensimit nga neni 45 i këtij ligji, të cilin e arkëton Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë, për vitin 2010 nuk mund të jetë më e lartë se 0,2% në vit.

Neni 71

Dispozita nga neni 46 i këtij ligji për investim të depozitave në banka të cilat kanë leje të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, nëse bartin kamatë dhe maturojnë në afat i cili nuk është më i gjatë se një vit, nuk ka të bëjë me depozitat e investuara në banka deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 72

Dispozitat nga nenet 47 paragrafi (3) dhe 48 të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, dispozitat nga neni 47 paragrafi (3) të këtij ligji, në periudhë prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, më së shumti 5% nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional mund të investohen në depozita dhe certifikata për depozitë në një bankë, e cila ka leje të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, me ç'rast më së shumti deri më 7,5% nga mjetet e fondit të detyrueshëm pensional, mund të investohen në depozita dhe certifikata për depozitë të bankave të lidhura ndërmjet veti.

Neni 73

Nenet 139-b, 139-v, 139-g, 139-d dhe 139-gj shlyhen.

Neni 74

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 75

Autorizohet Komisioni Juridiko-Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 76

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.